



NGO NETWORK OF PEACE MOVEMENT –NOPM

Raporti monitorues i komitetit për politikë dhe financa, komitetit për komunitete dhe mbledhjeve te kuvendit komunal në Kamenicë

“Ngritja e llogaridhënies së institucioneve lokale dhe përmisimi i rolit të monitorimit të shoqërisë civile”, i cili mbështetet nga misioni i OSBE-së si pjesë e projektit " Mbështetja për fuqizim publik: Iniciativat e shoqërisë civile e përfituesve të komunitetit në regjionin e Gjilanit dhe të Prizrenit” që implementohet nga OJQ NOPM si partner implementues.

PERIUDHA E RAPORTIMIT 01 DHJETOR 2012 - 31 MARS 2013

Ky projekt është mbështetur nga misioni i OSBE-së në Kosovë



Hartuar dhe përgatitur nga: Besime Tusha dhe Sherafedin Vranja

Redaktuar nga: Sherafedin Vranja

Publikuar nga OJQ- Network of Peace Movement



Rr. Skenderbeu Nr# 28

62000 Kamenicë, Kosovë

Tel: +377 45 291 127

www.ngo-nopm.org

Maj 2013

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	3
1. HYRJA	4
2. REZULTATET E KUVENDIT KOMUNAL.....	5
3. REZULTATET E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA.....	6
4. REZULTATET E KOMITETIT PËR KOMUNITETE.....	7
5. PËRFUNDIMET.....	8

Përmbledhja ekzekutive

Pjesëmarrja e publikut në vendim-marrje si dhe mbikëqyrja e institucioneve lokale janë parime themelore fundamentale të qeverisjes dhe mënyrës së sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies si procese demokratike. Kuvendi Komunal, Komiteti për Politika dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete përfaqëson degën e legjislativit në komunë dhe ka përgjegjësi të kryej mbikëqyrjen e trupit ekzekutivit, kryetarit dhe administratës komunale.

Funksionimi legjitim dhe efektiv i kuvendit komunal si instrument mbikëqyrës kërkon që të jetë në pajtim me procedurat relevante dhe kornizën e përshkruar në veçanti tek ligji për Vetëqeverisje Lokale. Ky raport është përqendruar në efektshmërin e performancës në lidhje me angazhimin e anëtarëve gra në diskutime, njoftimet publike të kuvendit komunal, në takimet e komitetit për politike dhe financa, komitetit për komunitete dhe pyetje që kanë ngritur lidhur me çështjet në interesin e përgjithshëm për publikun.

Mbi gjitha, progresi në respektimin e dispozitave ligjore nga kuvendi komunal, komiteti për politike dhe financa, komiteti për komunitete si dhe progresi që kanë vërejtur gjatë periudhës së raportimit që është mbuluar nga monitorët e partnerit implementues- OJQ-së NOPM. Megjithatë, OJQ-ja NOPM ka vërejtur një numër mangësish si mungesa e pyetjeve të ngritura lidhur me çështjet e interesit të përgjithshëm ku pothuajse asnjë pyetje nuk është ngritura, as nga anëtarët e kuvendit komunal e as nga kryesuesi i kuvendit komunal, mungesa e angazhimit të anëtarëve gra të kuvendit, dhe komiteteve të obligueshme ku në diskutimeve e tyre në shumicën e rasteve kanë qene jo adekuate, të pamjaftueshme dhe jo produktive lidhur me ngritjen e çështjeve njëzëri.

Për të përmbledhur, OJQ-ja NOPM ka vëzhguar periudhën gjatë raportimit ku një numër i konsiderueshëm i grave në kuvendin komunal, komitetit për politike dhe financa dhe komitetit për komunitete nuk e kanë ngritur ndonjë çështje përgjatë seancave dhe për të plotësuar këtë raport fletënotimet për anëtarët të kuvendit komunal, komitetit për politike dhe financa, komitetit për komunitete janë përgatitur dhe të gatshme për institucione dhe për publikun në përgjithësi.

1. Hyrja

Korniza ligjore dhe rregullative¹ në Kosovë, në veçanti ligji për Vetëqeverisjes lokale Nr.03/L-040 i definon kërkesat e funksionimit të kuvendit komunal, komitetit për politike dhe financa dhe komitetit për komunitete dhe siguron mbrojtjen e pjesëmarrjes publike në proceset e vendim-marrjes. Kjo përfshin kërkesat për takime të hapur më kuvende komunale dhe për komitete obligative si dhe angazhimin e plotë të anëtarëve në çështjet e publikut dhe njoftimet të publikut lidhur me këto takime.

Synimi kryesor është që ti shërbej përfaqësuesve komunal, qytetarëve, shoqërisë civile si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë relevant që janë të përfshirë në çështjet e qeverisjes lokale si indikator për zhvillimin e mëtutjeshme në nivelin lokal.

Njoftimi në kohë i publikut për mbledhjet e ardhshme të kuvendit komunal, komiteteve obligative si dhe angazhimi i plotë në punën e këtyre organeve legjislative është informimi i qytetarëve, përforcimi dhe tërheqja e pjesëmarrësve të tyre në takime si mjetë për pjesëmarrjen e tyre në çështjet komunale dhe rritjen e performancës së tyre.

Raporti fokusohet në tri aspekte kryesore. Së pari, pyetjet lidhur çështjet e ngritura rreth interesit të përgjithshëm pothuajse as një herë nuk janë ngritur, as nga anëtarët e kuvendit komunal, as nga anëtarët e komitetit për politike dhe financa, komitetit për komunitete e as nga kryesuesi i kuvendit komunal të komitetit për politike dhe financa dhe komitetit për komunitete. Së dyti, komuna në mënyrë të vazhdueshme ka dështuar që t'i lajmërojë takimet e radhës, apo ka dështuar që ti lajmërojë në kohë në tërë territorin e komunës. Së treti, angazhimi i anëtarëve të grave të kuvendit dhe të komiteteve obligative në diskutime ka qenë jo adekuat, i pamjaftueshëm dhe jo produktiv që ti adresoj çështjet njëzëri. Një numër i konsiderueshëm i grave të kuvendit komunal, komitetit për politike dhe financa, komitetit për komunitete kanë dështuar që të ngritin ndonjë çështje gjatë periudhës së raportimit.

¹ Korniza ligjore përfshin standardet që burojnë prej Kartës Evropiane për Vetëqeverisjes Lokale dhe protokollet e saj.

2. REZULTATE E KUVENDIT KOMUNAL

Si pjesë e aktivitete të projektit, dy vëzhgues/monitorues të pranuar kanë marr pjesë në tri takime të kuvendit komunal, në kuvendin që është mbajtur përgjatë muajve dhjetorit 2012 dhe marsit 2013.

Takimet e kuvendit janë njoftuar me pjesëmarrje adekuate të anëtarët e tyre ku edhe disa kanë munguar por në shumicën e rasteve janë justifikuar dhe liruar nga kryesuesi i kuvendit.

Duke u bazuar në rezultate të monitorimit, performanca e anëtarëve të kuvendit ka qenë e konsiderueshme ku ata zakonisht kanë përcjellë pikat e agjendës dhe si rezultat i kësaj i kanë miratuar të gjitha pikatë e agjendës por jo të gjitha takimet janë përcjellë me diskutime të duhura. Vlen të përmendet se dhjetë(10) raporte vjetore të departamenteve komunale gjatë periudhës së raportimit të mbuluar nga ky raport janë miratuar me një diskutim jo të mjaftueshëm.

Sa i përket diskutimeve gjatë takimeve, kryesuesit e grupeve politike përfaqësues në kuvendin komunal kanë dominuar me sugjerime, propozime dhe iniciativa dhe të përcjellur me nga një numër të vogël të anëtarëve të tjerë të kuvendit. Në një ane negative, shumica dërrmuese e anëtarëve të kuvendit kanë dështuar që të ngritin ndonjë çështje për publikun në përgjithësi, përveç kryesuesit të grupit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës i cili ka ngritur çështjen e refuzimit të kompanisë publike të ujësjellësit në mënyrë që të instaloj orë matësit nëpër banesa. Megjithatë, asnjë veprim nuk është ndërmarr nga drejtori i shërbimeve publike dhe si shtesë nuk është bërë ndonjë as një hap në këtë drejtim gjatë kohës së monitorimit.

Si shtesë, takimet janë karakterizuar më akomodim jo adekuat për mbajtjen e takimeve ku ka pasur mungesë të kushteve elementare si nxemja qendrore për sallë ku të gjitha takimet janë mbajtur.

Si shtesë e kësaj, shërbimi profesional i kuvendit nuk ka siguruar gjithmonë në kohë të gjitha dokumentet për takimet dhe ka pasur raste ku materiali shtesë është siguruar gjatë takimit apo sa janë zhvilluar diskutimet për një pike të caktuar.

Gjatë monitorimit të seancave, Kuvendi komunal ka miratuara disa vendime dhe dy rregullore komunale. Kuvendi ka miratuar një përbërje të re të Këshillit për Siguri i Bashkësisë Komunale dhe ka miratuar ndarjen e bursave për 170 student për vitin 2013.

Si shtesë, dy komisione janë ngritur: shtatë anëtarë të komisionit për dhënie me qira pronës komunale për kohëzgjatje afate-shkurt dhe afate-gjate dhe pesë anëtarë të komisionit për organizimin e zgjedhjen e këshillave lokal te fshatrave. Veç kësaj, rregullorja për ofrimin e ndërtesave komunale dhe pronës për përdorimi afat-shkurt përmes ankandëve është miratuar, dhe asnjë debat publik nuk është organizuar. Së fundi, rregullorja për barazi gjinore është miratuar nga kuvendi komunal më 29 Mars 2013.

3. REZULTATET NGA TAKIMET E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Takimet e komitetit për politikë dhe financa janë mbajtur në përgjithësi me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të komitetit për politikë dhe financa të cilët e kanë rishikuar dhe diskutuar të gjitha pikat e agjendës; sidoqoftë gjatë monitorimit OJQ-ja NOPM ka vërejtur se asnjë propozim nuk është bërë që të ndryshohet përmbajtja e ndonjë pike të agjendës.

Veç kësaj, anëtarët e komitetit për politikë dhe financa janë thirrur në mbledhje me diskutime të pakëta të pikave të agjendës. Kjo ishte kryesisht gjatë debatit të raportit të punës vjetore të departamentit komunal për vitin 2012. Si shtesë, anëtarët e komitetit për politikë dhe financa kanë biseduar shkurtimisht dhe e kanë përcjellë si paketë tek kuvendi komunal me katër raporte të brendshme të auditimit pa bërë asnjë diskutim të duhur. Raporti i auditimit të Auditorit të Përgjithshëm shkurtimisht është diskutuar dhe përcjellë si paketë tek kuvendi komunal me katër raporte të brendshme të auditimit pa ndonjë diskutim të duhur. Raporti i auditimit të auditorit të përgjithshëm shkurtimisht është diskutuar dhe përcjellur në kuvendi pa ndonjë vërejtjeje të ngritur nga anëtarët e komitetit për politikë dhe financa.

Faktori tjetër që e ka portretizuar monitorimin e takimeve të komitetit për politikë dhe financa ishin pothuajse anëtarët e njëjte që kanë diskutuar pikat e agjendës.

Përveç kësaj, takimet e monitoruar gjatë periudhës dhjetor 2012 dhe mars 2013 janë karakterizuar me akomodim jo adekuatë për mbajtjen e takimeve ku ka pasur mungesë të kushteve themelore të ngrohjes qendrore për sallën ku janë mbajtur të gjitha takimet.

Vlen te theksohet se, anëtarët e grave të komiteti për politikë dhe financa në mënyrë të fuqishme e kanë mbështetur iniciativën e zyrtares komunal për barazi gjinore dhe grupit formal te grave që ka pasur të bëjë me hartimin e rregullores së barazisë gjinore. Si përfundim, niveli i angazhimit dhe aktivizimit të anëtarëve të grave të komitetit për politikë dhe financa ishte joadekuatë për të gjitha takimet e monitoruara përveç prej takimit të komitetit për politikë dhe financa kur ka qenë e diskutuar dhe e dërguar për miratimin e rregullores së barazisë gjinore e cila në mënyrë të fuqishme është mbështetur nga të gjitha anëtarët e grave të komitetit për politikë dhe financa.

4. REZULTATE E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Takimet e komiteti për komunitet janë mbajtur në përgjithësi me pjesëmarrjen e të të gjithë anëtarëve të komitetit për komunitete dhe asnjë anetare nuk ka munguar në takime.

Megjithatë, përmbajtja e agjendave është mbetur pothuajse e njëjte gjatë monitorimit të takimeve kur kryesisht është biseduar lidhur me projektet infrastrukturore dhe vetëm një raport është diskutuar, raporti e punës së zyrës komunale për komunitet dhe kthim në të cilën vetëm shefi i zyrës ka te informuar pranishmit rreth raportit të punës dhe se asnjë pyetje nuk është ngritur rreth këtij raporti.

OJQ-ja e ka vërejtur së kryesuesi i komitetit për komunitete ka dështuar që ti përcjell çështjet e diskutuara në komitetit për komunitete dhe ti dërgoj komitetit për politike dhe financa dhe kuvendit komunal për diskutim dhe miratim kur bëhet lidhur më kërkesa e projekteve infrastrukturore. Në anën tjetër si pozitive ishte se kryesuesi i komitetit për politikë dhe financa ka kërkuar të caktoj një anëtarë shtesë nga përfaqësuesit serb për komisionin që do të jetë përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve në këshillat e fshatrave dhe si rezultat i kësaj kuvendi komunal ka miratuar kërkesën e tij më 31 mars 2013.

Përveç se shërbimi profesionale i kuvendit jo gjithherë kanë siguruar në kohë të gjitha dokumentet e kërkuara për takimet dhe ka pasur raste ku tri takimet e komitetit për komunitete janë mbajtur pa procesmbajtës te procesverbalit ku pastaj janë paraqitur probleme dhe pakënaqësi kur procesverbalet e takimeve janë miratuar.

Ngjashëm me takimet e kuvendin komunal dhe komitetin për politikë dhe financa, komitetin për komunitete që janë monitoruar gjatë periudhës dhjetor 2012 deri mars 2013 janë

karakterizuar me akomodim joadekuatë për mbajtjen e takimeve ku ka pasur mungesë të kushtet themelore si ngrohja qendrore e sallës ku te gjitha takimet janë mbajtur në atë sallë.

Si përfundim, niveli i angazhimit dhe aktivizimit të anëtarëve të grave të komitetit për komunitete ishte jo adekuatë dhe i pamjaftueshme për shtyrë çështjet e interesit te përgjithshëm për te gjitha takimet e monitoruara.

5. PËRFUNDIMET

Përfundimisht, progresi është vëzhguar në funksionimin e takimeve të kuvendit komunal, komitetit për politikë dhe financa, komitetit për komunitete gjatë periudhës së raportimit dhjetor 2013 dhe mars 2013.

Në të vërtetë, numër i konsiderueshëm i takimeve të monitoruar ka dështuar që bëjnë lajmërimin e takimeve dhe publikimin e agjendave brenda kornizës së kërkuar. Nëse qytetarët nuk janë të informuar rreth takimit dhe përmbajtjes së diskutimeve, atyre iu ka mohuar mundësin e pjesëmarrjes në mbledhje dhe në këtë mënyrë pjesëmarrjen në zhvillimin e politikës komunale. Përveç kësaj, njoftimet publike shumë shpesh kanë dështuar për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve sepse njoftimet nuk janë shpërndarë në mënyrë të mjaftueshme në tërë territorin e komunës.. Për më shumë, ky raport nënvizon mungesën e prezencës publike në takime si probleme të përgjithshme. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes publike është si shkak i shumë faktorëve duke përfshirë shpërndarjen jo adekuate dhe të pamjaftueshme komunale për qytetarët. Sa i përket parimit të barazisë së përdorimit të gjuhëve, të shërbimeve të përkthimit ato janë ofruar nga administrata gjatë takimeve të kuvendit komunal dhe mbledhjeve tjera te komiteteve.

Sidoqoftë, mungesa apo pjesëmarrja e publikut në numër të vogël në takimet e kuvendit komunal ka vazhduar. Pothuajse në të gjitha takimet e monitoruara është siguruar shërbimet e interpretimit, por nuk ka pasur përkthime të te gjitha materialeve në takimet e kuvendit komunal në gjuhët zyrtare siç kërkohet nga ligji i gjuhëve zyrtare. Se fundi, monitorimi on-line/direkt nga Ministria e Administrimit te Pushteti Lokal i takimeve te kuvendit komunal është kryer në mënyrë të suksesshme në komunë duke sjellë më shumë sjellje transparente në proceset e vendim-marrjes komunale.